

LMS DHE MOOCS, KONCEPTET E AVANCUARA TË E-LEARNING

ALBA ÇOMO., ROMINA SHQYPI., SIDORELA BALLA.

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Departamenti i Informatikës

e-mail: alba.como@fshn.edu.al

Përmbledhje

Zhvillimi i teknologjisë dhe përdorimi i gjerë i materialeve dixhitale kanë sjellë ndryshime drastike në çdo aspekt të jetës së përditshme dhe kjo gjë normalisht ka ndikuar edhe në fushën e mësimi. Mësimi online (apo e-learning) është konsideruar si revolucioni më i madh në fushën e arsimit. Për shkak të natyrës shumë dimensionale që ka vetë e-learning janë krijuar edhe shumë platforma dhe koncepte të cilat në një mënyrë apo një tjetër përfaqësojnë të gjitha ato cilësi që karakterizojnë e-learning. Jo vetëm që ka koncepte të ndryshme që i referohen e-learning, por termi edhe është zëvendësuar nga të tjerë, siç janë LMS (Learning Management System) apo MOOCs (Massive Open Online Courses). Pikërisht për të kuptuar më thellësisht të gjithë këtë proces se si funksionon, është marrë në studim një nga platformat më të mëdha të e-learning, EDUonGo. EDUonGo implementon teknologjitë më të fundit në një Platformë Mësimore. Shkollat, institucionet dhe individët bashkëpunojnë me EDUonGo për të organizuar akademi online nëpërmjet platformës së saj cloud. Në një përpjekje për të stimuluar mjedisin arsimor, EDUonGo është projektuar për të motivuar bashkëpunimin e nxënësve dhe nxitur komunitetet e të mësuarit. Prioritetet më të mëdha të EDUonGo janë opsionet e përshtatjes, çmimet fleksibël dhe mbështetja e klientëve. Por gjithashtu EDUonGo fuqizon dhe mbështet një nga MOOCs më të mëdha në trevat shqiptare që është ALMOOC.

Fjalëkyçe: Teknologji, arsimi, *e-learning*, LMS, MOOC.

Abstract

Technology development and the widespread use of digital materials have led to drastic changes in every aspect of everyday life, and this has normally affected the field of learning as well. Online learning (or *e-learning*) is considered the largest revolution in the field of education. Due to the multi-dimensional nature of *e-learning* itself, many platforms and concepts have been created which in one way or another represent all the qualities that characterize *e-learning*. Not only are there different concepts that refer to *e-learning*, but the term has also been replaced by others, such as the LMS (Learning Management System) or MOOCs (Massive Open Online Courses). Just to understand more deeply this process of working, one of the biggest *e-learning* platforms, EDUonGo, is being studied. In itself, this platform has incorporated two of the most important *e-learning* concepts. It represents one of the most popular LMS such as EDUonGo. EDUonGo brings together the latest technology in a Learning Platform. Schools, institutions and individuals cooperate with EDUonGo to organize online academy through its cloud platform. In an effort to stimulate environmental education, EDUonGo is designed to motivate students' cooperation and promote learning communities. EDUonGo's major priorities are

accessibility, price flexibility and customer support. But EDUonGo also empowers and supports one of the largest MOOCs in Albanian lands that is ALMOOC.

Keywords: Technology, education, *e-learning*, LMS, MOOC.

Hyrje

Teknologjia është tashmë pjesë e pandashme e jetës tonë të përditëshme dhe si e tillë është e pranishme në të gjitha fushat jetësore. Një nga fushat më të rëndësishme të shoqërisë siç është edukimi, ka patur implementime dhe përfshirje të gjithanshme të teknologjisë, që nga pajisjet për të lehtësuar procesin e të mësuarit e deri në lindjen e metodave të reja të mësimdhënies.

Koncepti i të mësuarit ka evoluar me hapa shumë të shpejtë dhe sot nuk mund të krahasohet me mënyrën si konceptohej përpara disa vitesh ky proces. Teknologjia ka ecur me hapa galopante dhe kjo gjë normalisht ka ndikuar edhe në fushën e mësimit. Metoda e të mësuarit online është një nga gjërat më normale në ditët e sotme për të gjitha fushat. Dhe në thelb të të gjithë këtij procesi është interneti. Me fuqinë që i jep interneti, mësimdhënia dhe të mësuarit ekspozohen ndaj sasive të mëdha të padepërtueshme të informacionit.

Teknologjitë e komunikimit elektronik, me mediat e tyre të shumta tekstuale dhe audio-vizive, dhe kapacitetin e tyre për të zgjeruar bashkëveprimin me kalimin e kohës dhe distancës, po transformojnë të mësuarit dhe të nxënësimit. Pavarësisht këtij ndikimi të gjerë dhe diskutimit të madh dhe në rritje në lidhje me këtë temë, zhvillimet në teknologjitë e komunikimit dhe miratimi i tyre në akademi, kanë tejkaluar aftësinë tonë të të kuptuarit të mënyrës se si mund t'i përdorim ato për të mbështetur përvojën arsimore. Cilësitë që do të vlerësohen në një "të ardhme të bazuar në dije" do të jenë aftësia për të aksesuar dhe kuptuar informacionin. Kjo është një sfidë shumë e madhe dhe nuk ka rregulla të thjeshta apo receta për hartimin dhe ofrimin e një përvoje efektive *e-learning*. Një eksperiencë *e-learning* kërkon njohurinë dhe gadishmërinë e një mësuesi reflektues dhe të ditur, i cili mund të përkthejë parimet dhe udhëzimet për të papriturat dhe kërkesat që mund të lindin. Kjo kërkon aftësi të të menduarit kritik.

Elementët e përbashkëta të mësimit në distancë dhe mësimit online, sidomos mundësia që studentët të angazhohen në klasa dhe lëndë mësimore pavarësisht distancës gjeografike, kanë bërë që studiuesit t'i lidhin ato së bashku, shpesh me edukimin online si një zgjerim i edukimit në distancë. Por edukimi online apo *e-learning* gjatë dekadave kanë përjetuar edhe devijime apo specifitime të shumta që janë përkthyer në lindjen e formave të ndryshme të mësimit në distancë. Ndër këto specifitime që kanë lindur vitet e fundit janë MOOCs, të cilët kanë gjetur përhapje dhe përdorim shumë të gjerë në shoqëri. Kjo edhe për vetë atë që MOOCs simbolizojnë apo përfaqësojnë "Kurse online masive dhe të hapura për të gjithë". Në këtë punim trajtohen këto dy koncepte (LMS dhe MOOCs), si për ngjashmëritë, ashtu dhe dallimet që kanë midis tyre lidhur me ato çka ato ofrojnë. Për ti

konkretisht këto ngjashmëri dhe dallime janë marrë në studim platforma LMS EDUonGo dhe platforma ALMOOC .

LMS

LMS (Learning Management Systems) është identifikuar si një teknologji e nevojshme për të zbatuar në mënyrë efektive qasjet e reja të mësimin të përshtatshme për epokën e informacionit, të cilat kërkohen të shkëputen nga qasjet joefikase të epokës industriale (William, *et. al*, 2007). LMS është korniza që merret me të gjitha aspektet e procesit mësimor. Një LMS është infrastruktura që ofron dhe menaxhon përmbajtje mësimore, identifikon dhe vlerëson të mësuarit individual dhe të organizuar ose qëllimet e trajnimit. Gjithashtu ndjek progresin drejt përmbushjes së këtyre qëllimeve dhe mbledh dhe paraqet të dhëna për mbikqyerjen e procesit të të mësuarit të organizatës në terësi (Coates *et. al*, 2005). Një LMS ofron përmbajtje por gjithashtu trajton regjistrimin në kurse, administrimin e kurseve, analizimin e boshllëqeve të aftësive, ndjekjen dhe raportimin (Hoffman V. 2017).

Specifikimet e sakta për LMS ndryshojnë nga sistemi në sistem, ato zakonisht ofrojnë mjete për administrimin e kurseve dhe funksionet pedagogjike të ndryshme të sofistikuara dhe potenciale (Coates *et. al*, 2005):

- Komunikim asinkron dhe sinkron (fushat e njoftimit, e-mail, chat, mesazhet e menjëhershme dhe forume diskutimi);
- Zhvillimi dhe shpërndarja e përmbajtjes (burimet e të mësuarit, zhvillimi i repozitorëve të objekteve mësimore dhe lidhjet me burimet e internetit);
- Vlerësimi formativ dhe përmbledhës (dorëzimi, testimi me zgjedhje të shumëfishta, puna bashkëpunuese dhe feedback); dhe
- Menaxhimi i klasës dhe përdoruesve (regjistrimi, përfshirja, shfaqja e orareve, menaxhimi i aktiviteteve të studentit dhe orëve elektronike).

Ndryshimi i mënyrës së të mësuarit ndiqet nga orientimi drejt kurseve online të cilat po zëvendësojnë gjithnjë e më shumë klasat tradicionale. Nxënësit gjithnjë e më shumë konsiderohen të jenë ndërtues aktivë dhe jo marrësit pasivë të njohurive. Ndërsa kjo prirje rritet, janë shfaqur pyetje në lidhje me zgjedhjen e një sistemi të menaxhimit të të nxënit si për shembull: Çfarë e bën një sistem menaxhimi të të nxënit efikas? Si të zgjedhim një LMS sipas nevojave që kemi?

Krahasimi i LMS-ve

Përzgjedhja e një LMS është kritike për suksesin e studentëve. Kjo përzgjedhje duhet të bazohet në të dy objektivat, e kursit online dhe nevojat e nxënësve. LMS duhet të ketë komponentë që do t'i lejojnë instruktorit të krijojë një kurs që thekson përvojat aktive të të nxënit (Lewis B. A., MacEntee V. M. 2005).

Përgjatë punimit janë krahasuar 9 sisteme të menaxhimit të të mësuarit dhe janë nxjerrë në pah tiparet e produktit që rrisin aftësinë e tyre për të

akomoduar të nxënimit aktiv. Çdo program LMS bazohet në aftësinë për të akomoduar eksperiencën të ndryshme aktive të nxënimit në kurset online. Programet LMS të cilat janë studiuar janë WebCT, v.4.1; BlackBoard, v. 6.1; Jones E-education; Educator; Angel; .LRN; McGraw Hill Pageout; Moodle; dhe e-College AU. Krahasimi do të pasqyrojë perspektivat e fakultetit dhe studentëve.

Një sistem i menaxhimit të nxënimit duhet të adresojë nevojat e përdoruesit fundor: nxënësit. Secila LMS ka karakteristika kyçe që u lejojnë studentëve të jenë aktivisht të përfshirë në kurset e tyre. Tiparet kryesore të sistemeve të menaxhimit të mësuarit zgjerojnë mësimdhënien dhe mësimnxënien dhe angazhojnë nxënësit në një përvojë më të thellë mësimore (Lewis *et. al.*, 2017).

Në zgjedhjen dhe përdorimin e çdo lloji të instruksioneve mësimore, instruktori duhet të ketë komponente që do t'u lejojnë atyre të krijojnë kurse mësimore aktive. Mësimi nuk është aktivitet pasiv. Studentët marrin pjesë aktivisht në klasa tradicionale duke dëgjuar dhe duke biseduar me studentët e tjerë dhe instruktoren. Në një klasë online, një instruktor duhet të krijojë një mjedis ku nxënësit marrin pjesë aktivisht në mësim dhe diskutime. Përmes përdorimit të diskutimeve, studentët janë në gjendje të ndajnë përvojën e kaluar dhe t'i zbatojnë këto përvoja në jetën e tyre. Është kjo lidhje me studentët e tjerë dhe instruktoren që u lejon studentëve të ndjejnë se janë pjesë e kursit.

Çdo komponent i LMS është i rëndësishëm në përvojën e të mësuarit të studentit. Komponentët e duhur bëjnë që një kurs të cilësohet si kurs i mirë dhe komponenti i gabuar mund të shkatërrojë një kurs. Për të krahasuar LMS-t (WebCT, v.4.1; BlackBoard, v. 6.1; Jones E-education; Educator; Angel; .LRN; McGraw Hill Pageout; Moodle; dhe e-College AU) jemi bazuar në komponentët e mëposhtëm:

- **Instruktorët** - Instruktorët duhet të jenë në gjendje të ngarkojnë më shumë se vetëm shënimet e leksioneve në një kurs në internet. Ata duhet të jenë në gjendje të ngarkojnë dhe të redaktojnë përmbajtje në linjë. Ata gjithashtu duhet të krijojnë përmbajtje bazuar në aftësinë e nxënësve për të përpunuar dhe kuptuar përmbajtjen e kursit. Zhvillimi i përmbajtjes duhet të jetë koherent dhe logjik, me sekuencë, në një mënyrë që nxënësit mund ta ndjekin kursin lehtë. Prandaj, një instruktor duhet të zgjedhë një LMS që mbështet një qasje me në qendër studentin. Duhet të lejojë instruktoren të hartojë materiale me cilësi të lartë. LMS duhet të përfshijë mekanizmat mbështetës që janë të disponueshëm online për nxënësit.
- **Zona Diskutimi** - Kursi online i cili përmban vetëm shënime për leksionet ose prezantime me slide nuk u lejon përdoruesve të marrin pjesë aktive në kurs. Shtimi i diskutimit sjell një element dinamik në klasën online. Është çelësi për ta bërë kursin një përvojë interaktive. Diskutimet u lejojnë studentëve të komunikojnë me njëri-tjetrin dhe me instruktoren. Diskutimet

lejojnë studentët të kenë një rol aktiv në ndërtimin e përvojës së tyre të të mësuarit.

- Pjesëmarrja në grup - LMS lejojnë studentët të punojnë së bashku në grupe të vogla ose të mëdha. Ata janë në gjendje të ndajnë dokumente, të bisedojnë, të dërgojnë postë elektronike dhe të punojnë së bashku në mjedise sinkron dhe asinkron. Studentët nuk kanë nevojë të takohen personalisht për të punuar së bashku. Ata mund të bëjnë gjithçka online. Studentët e pëlqejnë këtë veçori, sepse shumë herë ata nuk janë në të njëjtin qytet, shtet ose vend me njëri-tjetrin.
- Chat / E-Mail - Interaktiviteti në një kurs online është çelësi. Fushat e diskutimit nuk janë mënyra e vetme e ndërveprimit ndërmjet student-student dhe student-instrukturë. Një instruktor i kursit të historisë së shkollës së mesme mund t'i ofrojë studentit mundësinë që të angazhohet në një diskutim/chat në internet rreth tematikave të ndryshme siç mund të jetë lufta civile. Instruktori mund të ketë nxënës të ndryshëm që i përgjigjen pyetjeve dhe madje bëjnë pyetje të ndryshme në bisedë. E-mail-i është një komponent kyç për një kurs në internet. Ky është një mjet për të bërë një lidhje me studentët. Instruktori mund të përdorë postën elektronike si një metodë e shpejtë për të kontaktuar studentët ose për të dërguar shënime për ata që kanë nevojë për më shumë sqarime. E-maili është një mjet i mirë për grupet që të komunikojnë me njëri-tjetrin.
- Monitorimi i pjesëmarrjes dhe progresit të studentëve - Në një kurs tradicional, një instruktor mund të marrë pjesë. Megjithatë, instruktorët nuk e dinë nëse studentët po lexojnë apo i kushtojnë vëmendje diskutimeve. Në një kurs në internet, një instruktor mund të monitorojë nga afër një student. Mund të tregohet se kur studenti hyn në një kurs dhe për sa kohë ai është në kurs në një kohë të caktuar. Gjithashtu, instruktorët monitorojnë se në sa diskutime një student lexon dhe përgjigjet; mund të gjurmojnë kur dhe sa faqe të përmbajtjes studentët shohin. Instruktorët mund të klasifikojnë punën e studentëve nëpërmjet zonave të dorëzimit të detyrave dhe klasat të vendosën automatikisht në librin e notave. Pasi instruktorët kanë vlerësuar detyrat, studentët janë në gjendje të shohin notat e tyre dhe çdo reagim për detyrat. Jo vetëm që studentët mund t'i shikojnë notat e tyre të caktuara, por të gjitha klasat e tyre në internet.

LMS përdoren globalisht, në shumë industri të ndryshme. Ajo përdoret gjithashtu nga korporatat për efekte mesimi. Miratimi i LMS ka qënë në rritje gjatë viteve të fundit në mbarë botën. Gjatë një ankete të bërë nga *e-learning Guild* në vitin 2009 gjatë 12 muajve të këtij viti, rreth 700 të anketuar në një sërë industrish raportuan mbi produktin LMS që po përdorin. Globalisht më shumë se 88 % e të anketuarëve raportojnë se janë duke përdorur LMS në organizatat e tyre. Figura 1 tregon se shumica e të anketuarëve 83.40% - vijnë nga sektorët komercialë/industri komerciale (Davis *et. al*, 2009).




Figura 1. Anketimi mbi përdorimin e LMS

LMS vs MOOCS

Teknologjia është tashmë pjesë e pandashme e jetës tonë të përditshme dhe si e tillë ajo është e pranishme dhe në fushën e edukimit, duke patur shumë implementime që nga paisjet për të lehtësuar procesin e të mësuarit e deri në lindjen e metodave të reja të mësimdhënies. Me lindjen e këtyre metodave kanë lindur dhe konceptet e reja LMS dhe MOOCs.

Fillimisht përpara se të bëjme dallimet midis LMS dhe MOOCs duhet të themi që të dyja këto koncepte kanë rrënjë të përbashkët në atë fushë moderne që ndërthur teknologjinë me edukimin e cila quhet *e-learning* dhe që në thelb ka të bëjë me të mësuarit përmes internetit duke ndjekur leksione virtuale të cilat organizohen në mënyra të ndryshme (Nielson B. 2015). E tashmë për të realizuar një dallim midis këtyre dy koncepteve të avancuara të edukimit nisemi nga mënyra se si ato ofrohen për studentët që janë edhe pjesa më e rëndësishme e këtij sistemi (Nielson B. 2015).

- Nga vetë akronimi tek MOOCs themi që kurset janë të hapura në çdo periudhë të vitit për çdo student. Ndërkohë në LMS kurset janë me pagesë dhe në varësi të institucionit ato mundet ose jo të jenë të hapura gjatë gjithë vitit.
- Duke u nisur edhe nga ky fakt mund të themi që pjesëmarrja në kurset MOOCs është më e madhe se sa në ato të LMS ku marrin pjesë vetëm studentët e vetë institucionit.
- Suporti për studentët që kanë vështirësi në kurset MOOCs mund të jepet si nga instruktorët ashtu edhe nga studentët e tjerë që ndjekin kurse, por jo gjithmonë ky suport është i saktë dhe profesional. Ndërkohë që në kurset e LMS suporti ofrohet nga stafi mësimdhënës që është gjithmonë i kualifikuar në atë fushë.

- Në MOOCs kemi gamë të gjërë të mjeteve të komunikimit që përfshijnë forumet blogjet e madje edhe rrjetet sociale, ndërkohë që tek LMS komunikimi realizohet përmes forumeve të diskutimit.
- Përmbajtja e kurseve të MOOCs përditësohet paralelisht me përditësimin e teknologjive apo koncepteve të caktuara. Ndërkohë që kurset LMS janë kryesisht të porositura dhe si të tilla janë më pak fleksibël ndaj ndryshimeve.
- Në kurset MOOCs një student mund bëhet instruktor dhe anasjelltas (dhe kjo mund të çënojë cilësinë e kurseve), ndërsa në LMS kurset hartohen dhe realizohen nga trajnerë në bazë të një procesi hierarkik.
- Kurset në MOOCs janë të hapura pavarësisht nivelit arsimor, por që të kuptohen dhe të japin rezultatet e duhura kërkojnë aftësi dixhitale. Ndërkohë që kurset LMS e njohin shumë mirë target grupin dhe aftësitë që ata kanë përputhen me ato të kursit.

EDUonGo

Pasi kemi ilustruar krahasimin mes platformave LMS dhe MOOCs, mëposhtë do të përshkruajmë platformën EDUonGo. EDUonGo është një ndër platformat më të përhapura në Amerikë, si një platformë të fushës së LMS. U krijua në vitin 2013 nga një inxhinier kosovar për nevojat e stafit të tij dhe tashmë ju vjen në ndihmë institucioneve, instruktorëve dhe studentëve, si dhe bizneseve në të gjithë botën.

EDUonGo është një platformë LMS e bazuar 100% në Cloud. Ofron lançim të shpejtë, pra krijimin dhe menaxhimin në kohë reale të një kursi. Ju ofron mundësinë e krijimit dhe menaxhimit të kursit tuaj në lidhje me atë çka mund të shohin studentët dhe asaj çka doni të publikoni. Aty mund të lejoni rregjistrimin dhe menaxhimin e studentëve që janë rregjistruar. Forum për diskutime për të diskutuar në lidhje me koncepte dhe çështje të caktuara, apo edhe për të diskutuar në lidhje me çështje që studentët i kanë të paqarta nga kursi që kanë ndjekur. Përveç këtyre ofron mundësinë e gjenerimit të raporteve në lidhje me ecurinë e studentëve, për të parë progresin e tyre, apo edhe raporte në lidhje me ndjekshmërinë e kursit. Ofron mundësinë e krijimit të sesioneve live nëpërmjet të cilave kemi edhe mundësinë e komunikimit të drejtpërdrejtë me përdoruesit e LMS. Gjithashtu dhe bibliotekën ‘e-Book’, ku mund të ruhen materialet e leksioneve apo edhe materiale të tjera që i nevojiten instruktorëve apo studentëve.

Një prej avantazheve kryesore të platformes EDUonGo është bashkëpunimi me palet e treta. EDUonGo ka bashkëpunim me Microsoft, ku është e disponueshme në dyqanet Office dhe gjithashtu ndodhet në Office 365 si një partner edukimi. EDUonGo, është i integruar në Microsoft OneNote dhe listohet si një funksionalitet në faqen e OneNote. Gjithashtu është i integruar edhe në Office Mix, i lidhur me Skype dhe Onedrive. Përveç, kësaj kjo platformë ka dhe disa avantazhe krahasuar me platformat e tjera LMS, si:

- Platformë online e cila ofron siguri të të dhënave

- Kurseni kohë dhe kosto
- Rrit kapacitetin dhe audiencën
- Rritja e efikasitetit të procesit të mësimdhënies
- Mundëson bashkëpunimin dhe angazhimin
- Lehtësim në ndjekjen e trajnimit
- Ju mund të krijoni brendin(përshtasni templat-in per organizatën tuaj) tuaj
- Ofron një mjedis miqësor



Figura 2. Bashkëpunimi i EDUonGo

Përse duhet të përdorim EDUonGo? Nëse rendisim arsyt pse duhet të përdorim EDUonGo mund të themi se:

- Ofron zgjidhje të problemeve pa kosto ekstra
- Menaxhim dhe përditësim në kohë reale
- Mbështetje dhe Shërbim Teknik 24/7
- Mirëmbajtje me kosto të ulët
- Kërkon Instalim minimal në Web
- Plotësisht i personalizueshëm dhe fleksibël
- Jep mundësinë të mësoni dhe lidheni në çdo kohë me njerëzit
- Partnerë të teknologjisë dhe vlerësimit

ALMOOC

Mëposhtë do të analizojmë një zgjerim apo një funksionalitet shtesë që ka EDUonGO dhe kjo është platforma ALMOOC.

ALMOOC është një ndër platformat e para dhe ndër më të mëdha që ofrojnë të mësuarit online në trevat shqiptare. U krijua nga i njëjti ideator i EDUonGo, dhe i'u dedikua studentëve të trevave shqiptare. ALMOOC ose ndryshe Albanian MOOC ka si nismë të saj kryesore Edukimin Online dhe ta aplikojë atë në publik të gjerë dhe falas. MOOC është e aplikuar në shumë vende të botës dhe sillet në vendet shqip-folëse me anë të ALMOOC. Vizioni i ALMOOC është që të ndërtojë talente që i shërbejnë tregut ndërkombëtar dhe që të kontribuojnë sa më mirë në ekonominë e vendeve shqipfolëse duke e bërë profesionalisht të aftë rininë si për tregun vendas, ashtu edhe për atë ndërkombëtar.

Kjo platformë edukative bashkëpunon me profesorë të dalluar të botës shqiptare për t'ju ofruar klasa "online" të gjithëve FALAS. Ata parashikojnë një të ardhme ku çdokush të ketë akses në edukim kualitativ. Ata kanë për qëllim që të fuqizojmë të rinjtë në arsim për të përmirësuar jetën e tyre, të familjeve të tyre, dhe të komunitetit ku ata jetojnë.

Misioni i ALMOOC është të sigurojë kurse cilësore falas për lëndët e kërkuara me anë të metodës të njohur MOOC. Të tërheqin një komunitet prej qindra shqiptarësh për të krijuar kurse sa më cilësore dhe të filtrojnë talentet duke i ndihmuar ata që të arrijnë objektivat e tyre në jetë. Synimi kryesor i tyre është t'u japin rinisë shqiptare aksesin në edukim të avancuar dhe mundësi shprehjesh të aftësive profesionale.

Vizioni i ALMOOC është që të ndërtojë talente që i shërbejnë tregut ndërkombëtar dhe që të kontribuojnë sa më mirë në ekonominë e vendeve shqipfolëse. Ai bashkëpunon me instruktorë të spikatur në një sërë fushash, me qëllim mundësimin e dhënies së kurseve profesionale online në gjuhën shqipe dhe sot numëron më shumë se 60.000 studentë nga të gjitha trevat shqiptare, te cilët jo vetëm që ndjekin kurset e Almooc, por marrin pjesë edhe në konkurset apo fushatat ndërgjegjësuese që Almooc organizon. Duke patur shumë përfitime ndër të cilat: punë në klasë të mbikqyrur nga instruktori, pyetsor online për të testuar njohuritë e përfituara, çertifikim online për kodim nga code.org, testim i njohurive përmes projekteve të dorëzuara, mundësi punësimi në kompani ndërkombëtare, pjesëmarrje në evente ndërkombëtare dhe jo vetëm, diplomë nga shkollë amerikane dhe mbi të gjitha aftësi për të zhvilluar një karrierë të suksesshme.

Edhe pse shifrat dhe statistikat janë thuajse të një anëshme, duhet theksuar që Almooc ka ndihmuar shumë studentë për të arritur rezultate më të larta në shkollë si dhe për tu njohur me terma dhe teknologji që në trevat shqiptare ende nuk janë zhvilluar.

Duke u bazuar në studimin e kryer nga profesori nga Kosova Ramadan Beqiri (Beqiri R. 2015), mund të themi se ndërrimi i metodologjive të të mësuarit rrit interesimin e nxënësve për qasje në këto rrugë të reja, të cilat janë të pranueshme dhe lehtësisht të zbatueshme në rastet kur plotësohen disa kushte teknike, të cilat janë të domosdoshme për realizimin e tyre. Nxënësit kalojnë kohë të gjatë pranë kompjuterit duke lundruar në portale të ndryshme dhe rrjete të tjera sociale, të cilat ua rrëmbëjnë kohën dhe ua harxhojnë energjitë, duke i lodhur aq shumë sa të mos kenë më fuqi për të mësuar. Zëvendësimi sado i vogël i portaleve të tilla me ato edukativo-arsimore, nxitë të mësuarit e shkencave të natyrës nëpërmjet platformës së të nxënësve nga distanca (*e-learning*). Përdorimi në masë sa më të gjerë i platformës virtuale ALMOOC, do të bënte që në platformë të shtoheshin edhe lëndë tjera të cilat janë të domosdoshme për studentë, nxënës madje edhe klasat e arsimit fillor.

Përfundime

Konceptet e avacuara të mësimdhënies i kanë dhënë fushës së edukimit një frymë tjetër shumë herë më të mirë dhe më efektive. Dhe secila prej e këtyre metodave ka avantazhet dhe disavantazhet e saj në krahasim me të tjerat. Përzgjedhja e metodës më të mirë varet nga kërkesat që ka një institucion apo individ.

Dhe për t'u ndalur me specifikisht te rasti konkret që trajtuam mund të themi që Almooc ka qënë një ndihmë e madhe për studentët e trevave shqiptare duke qënë i lehtë për tu përdorur si dhe për t'u aksesuar. Dhe në tërësi platforma EDUonGo tashmë ka një pozicion mjaft të mirë në treg falë mbështetjes që ofron për klientët e saj dhe nevojave që plotëson.

Literatura

Beqiri R. (2015): Ndikimi i të nxëniet nga shtëpia në ngritjen e rezultateve në mësim, Prishtinë

Coates H., James R., Baldwin G.(2005): A Critical Examination Of The Effects Of Learning Management Systems On University Teaching And Learning, Tertiary Education and Management 11: 19–36

Davis B, Carmean C., Wagner E.D.(2009): The Evolution of the LMS: From Management to Learning Deep Analysis of Trends Shaping the Future of *e-learning*. The eLearning Guild

Hoffman V. (2017): What is a Learning Management System (LMS)?. Decobo

Lewis B. A., MacEntee V. M.(2005): Learning Management Systems Comparison. Flagstaff, Arizona, USA

Lewis B. A., MacEntee V. M., Youngs-Maher P.(2017): Software Compare and Contrast: Blackboard, WebCT and Lotus Notes a Panel Discussion

Nielson B.(2015): What's the Difference Between a MOOC and an LMS?, Your Training Edge

Watson W.R., Watson S.L.(2007): An argument for clarity: what are learning management systems, what are they not, and what should they become?. TechTrends, Springer Verlag, 2007, 51(2), 28-34